**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës: | 2023:291784 |
| Datë: | 24.06.2024 |
| Numri i dokumentit: | 05850503 |

**K.Dh.Sh II.nr. 626/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-** Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbarimore të kreditorit "N.T.Sh GENCI" me NUI 810359522 dhe me seli në Mitrovicë, përfaqësuar nga B.K., avokat nga Mitrovica, kundër debitorit Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A me numër fiskal 600241880 dhe seli në rr. "Vëllezërit Dragaj" në Mitrovicë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.431/23 të datës 27.12.2023, me datë 24.06.2024 mori këtë:

## A K T V E N D I M

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A" me seli në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. KPPP.nr. 431/23 të datës 27.12.2023, **VËRTETOHET**.

## A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. KPPP.nr. 431/23 të datës 27.12.2023, ka Refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit N.T.Sh GENCI"me, seli në Mitrovicë ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 12/2023, i lejuar me datë



2024:105701

06.03.2023, nga Përmbaruesi Privat Ilmi Miftaraj, dhe Urdhri Përmbarimor P.nr. 12/2023, i lejuar me datë 06.03.2023, nga Përmbaruesi Privat Ilmi Miftaraj, mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 58/22 të datës 30.06.2023 dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori kreditorit "N.T.Sh GENCI" me NUI 810359522 dhe me seli në Mitrovicë, me dt. 06.03.2023, ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm faturë nr.20-SHV01-001-166 e datës 03.08.2020, nr.20- SHV01-001-367 e datës 15.12.2020, nr.20-SHV01-001-321 e datës 30.11.2020, nr.20-SHV01- 001-320 e datës 27.11.2020, nr.20-SHV01-001-297 e datës 25.11.2020, nr.20-SHV01-001-296 e datës 23.11.2020, nr.20-SHV01-001-291 e datës 20.11.2020, nr.20-SHV01-001-285 e datës 18.11.2020, nr.20-SHV01-001-280 e datës 13.11.2020, nr.20-SHV01-001-279 e datës 11.11.2020, nr.20-SHV01-001-233 e datës 30.09.2020, nr.20-SHV01-001-231 e datës 25.09.2020, nr.20-SHV01-001-186 e datës 31.08.2020, nr.20-SHV01-001-181 e datës 26.08.2020, nr.20-SHV01-001-179 e datës 20.08.2020, nr.20-SHV01-001-161 e datës 04.08.2020, nr.20-SHV01-001-25 e datës 08.03.2021, nr.20-SHV01-001-17 e datës 24.02.2021, nr.20-SHV01-001-16 e datës 22.02.2021, nr.20-SHV01-001-10 e datës 19.01.2021, nr.20-SHV01-001-9 e datës 14.01.2021, nr.20-SHV01-001-8 e datës 12.01.2021, nr.20-SHV01-001-7 e datës 08.01.2021, nr.20-SHV01-001-6 e datës 07.01.2021, nr.20- SHV01-001-5 e datës 05.01.2021, nr.20-SHV01-001-4 e datës 04.01.2021, nr.20-SHV01-001- 29 e datës 10.03.2021, nr.20-SHV01-001-30 e datës 11.03.2021, nr.20-SHV01-001-39 e datës 30.03.2021, nr.20-



2024:105701

SHV01-001-57 e datës 23.04.2021, nr.20-SHV01-001-58 e datës 26.04.2021, nr.20-SHV01-001-59 e datës 30.04.2021, nr.20-SHV01-001-82 e datës 24.05.2021, nr.20-SHV01-001-63 e datës 17.05.2021, nr.20-SHV01-001-100 e datës 02.06.2021, nr.20-SHV01-001-101 e datës 04.06.2021, nr.20-SHV01-001-102 e datës 07.06.2021, nr.20-SHV01-001-97 e datës 08.06.2021, nr.20-SHV01-001-96 e datës 08.06.2021, nr.20-SHV01-001-104 e datës 14.06.2021, nr.20-SHV01-001-120 e datës 06.08.2021, nr.20-SHV01-001-103 e datës 10.06.2021, nr.20-SHV01-001-190 e datës 13.10.2021, nr.20-SHV01-001-191 e datës 18.10.2021, nr.20-SHV01-001-222 e datës 22.10.2021, nr.20-SHV01-001-223 e datës 26.10.2021, nr.20-SHV01-001-189 e datës 01.10.2021, nr.20-SHV01-001-224 e datës 04.11.2021, nr.20-SHV01-001-225 e datës 11.11.2021, nr.20-SHV01-001-8 e datës 10.01.2022, nr.20-SHV01-001-9 e datës 11.01.2022, nr.20-SHV01-001-10 e datës 17.01.2022, nr.20-SHV01-001-11 e datës 24.02.2022, nr.20- SHV01-001-12 e datës 03.02.2022, nr.20-SHV01-001-86 e datës 28.06.2022, nr.20-SHV01- 001-98 e datës 19.07.2022, nr.20-SHV01-001-116 e datës 13.09.2022, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të mbetur të pa paguar t'i paguaj shumën prej 5,474.80 € (pesë mijë e katërqindën e shtatëdhjetë e katër euro e tetëdhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8 % nga data e arritjes së pagesës të secilës faturë deri në përmbushjen e obligimit përfundimtar si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore. Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kontestuar në tërësi Urdhrin për lejimin e përmbarimit, me arsyetimin se propozimin për përmbarim e konsideron si të paqenë dhe paushall meqë në programin e kontabilitetit pjesa më e madhe e faturave të prezantuara me propozim për përmbarim janë të evidentuar. Shton se pretendimi i kreditorit se ai është furnizuar nga viti 2020 deri në vitin 2022, nuk qëndron ngase kartela financiare/ekstrakti dëshmon se ka vetëm një bartje të borxhit nga viti në vit në shumë prej 983.30 €. Tutje thekson se kreditori me propozim nuk ka prezantuar kontratë të lidhur me kompaninë për furnizim, gjithashtu kreditori nuk ka prezantuar as urdhërblerje apo fletëkthesë të lëshuar nga ai, me të cilën dëshmon se kompania ka kërkuar produkte me të cilat kreditori pretendon se e ka furnizuar kompaninë e tij. Në fund shton se pagesa e fundit përkatësisht e datës 30.11.2020 me numër të faturës 20-SHV01-001-321 në shumë prej 99.40 € është paguar me grup të faturave në vlerë prej 10.80 € më shumë. Gjykatës i ka propozuar që ta hudhë poshtë pjesën e propozimit për përmbarim në vlerë prej 4,491.50 € dhe të caktoj ekspert financiar të pavarur për verifikimin e borxhit të pretenduar. Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit duke theksuar se prapësimi i debitorit është në tërësi në kundërshtim me LPP sepse duke u bazuar në



2024:105701

nenin 27 të LPP-së, citon "dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftëse për të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimeve" del që kreditori me anë të faturave të prezantuara i ka përmbush të gjitha kushtet e parapara me këtë nen. Shton se debitori në vet prapësimin e tij paraqet një pjesë të faturave të vitit 2020, ku në mënyrë direkt e pranon se e ka pranuar mall për furnizim nga ai e kjo dëshmohet qartë edhe me anë të nënshkrimit të personit përgjegjës për pranimin e mallit, i cili nënshkrim është evidentuar në faturat në të cilin e ka pranuar mallin (furnizimin nga kreditori). Në fund thekson se sa i përket kërkesës për caktimin e ekspertit nga ana e debitorit, e kundërshton në tërësi, pasi që borxhi është borxh i ditur, shumë është e caktuar në faturë po ashtu në kartelën blerëse është caktuar shuma, andaj caktimi i ekspertit do të ishte vetëm zvarritje e lëndës dhe shpenzimet të panevojshme për debitorin. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin, ta lë në fuqi Urdhrin Përmbarimor dhe të obligohet debitori t'i heq shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumë prej 80.00 €

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar me arsyetim se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se "Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm", ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se "Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar", dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se "Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit." Po ashtu ka cek se në rastin konkret vlerëson se faturat 03.08.2020, nr.20-SHV01-001-367 e datës 15.12.2020, nr.20-SHV01-001-321 e datës 30.11.2020, nr.20-SHV01-001-320 e datës 27.11.2020, nr.20-SHV01-001-297 e datës 25.11.2020, nr.20-SHV01-001-296 e datës 23.11.2020, nr.20-SHV01-001-291 e datës 20.11.2020, nr.20-SHV01-001-285 e datës



2024:105701

18.11.2020, nr.20-SHV01-001-280 e datës 13.11.2020, nr.20-SHV01-001-279 e datës 11.11.2020, nr.20-SHV01-001-233 e datës 30.09.2020, nr.20-SHV01-001-231 e datës 25.09.2020, nr.20-SHV01-001-186 e datës 31.08.2020, nr.20-SHV01-001-181 e datës 26.08.2020, nr.20-SHV01-001-179 e datës 20.08.2020, nr.20-SHV01-001-161 e datës 04.08.2020, nr.20-SHV01-001-25 e datës 08.03.2021, nr.20-SHV01-001-17 e datës 24.02.2021, nr.20-SHV01-001-16 e datës 22.02.2021, nr.20-SHV01-001-10 e datës 19.01.2021, nr.20-SHV01-001-9 e datës 14.01.2021, nr.20-SHV01-001-8 e datës 12.01.2021, nr.20-SHV01-001-7 e datës 08.01.2021, nr.20-SHV01-001-6 e datës 07.01.2021, nr.20- SHV01-001-5 e datës 05.01.2021, nr.20-SHV01-001-4 e datës 04.01.2021, nr.20-SHV01-001- 29 e datës 10.03.2021, nr.20-SHV01-001-30 e datës 11.03.2021, nr.20-SHV01-001-39 e datës 30.03.2021, nr.20-SHV01-001-57 e datës 23.04.2021, nr.20-SHV01-001-58 e datës 26.04.2021, nr.20-SHV01-001-59 e datës 30.04.2021, nr.20-SHV01-001-82 e datës 24.05.2021, nr.20-SHV01-001-63 e datës 17.05.2021, nr.20-SHV01-001-100 e datës 02.06.2021, nr.20-SHV01-001-101 e datës 04.06.2021, nr.20-SHV01-001-102 e datës 07.06.2021, nr.20-SHV01-001-97 e datës 08.06.2021, nr.20-SHV01-001-96 e datës 08.06.2021, nr.20-SHV01-001-104 e datës 14.06.2021, nr.20-SHV01-001-120 e datës 06.08.2021, nr.20-SHV01-001-103 e datës 10.06.2021, nr.20-SHV01-001-190 e datës 13.10.2021, nr.20-SHV01-001-191 e datës 18.10.2021, nr.20-SHV01-001-222 e datës 22.10.2021, nr.20-SHV01-001-223 e datës 26.10.2021, nr.20-SHV01-001-189 e datës 01.10.2021, nr.20-SHV01-001-224 e datës 04.11.2021, nr.20-SHV01-001-225 e datës 11.11.2021, nr.20-SHV01-001-8 e datës 10.01.2022, nr.20-SHV01-001-9 e datës 11.01.2022, nr.20-SHV01-001-10 e datës 17.01.2022, nr.20-SHV01-001-11 e datës 24.02.2022, nr.20- SHV01-001-12 e datës 03.02.2022, nr.20-SHV01-001-86 e datës 28.06.2022, nr.20-SHV01- 001-98 e datës 19.07.2022, nr.20-SHV01-001-116 e datës 13.09.2022 në bazë të së cilave është lejuar përmbarimi i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, kjo pasi që në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit dhe faturat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt përmes nënshkrimit të tyre. Gjithashtu thekson se në rastin konkret faturat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal. Në këtë rast, Gjykata vlerësoj pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim por gjeti



2024:105701

se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i mbështetur pretendimet e tilla, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar ka konstatuar drejtë faktin se faturat në fjalë, në bazë të cilës organi përmbarues ka caktuar përmbarimin janë dokumente të besueshëme e kjo parashihet në nenin 29 paragrafi 1 të LPP-së, ku ceket se: përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm sipas këtij ligji është edhe fatura. Në rastin konkret fatura përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit konform nenit 21 si dhe nenit 29 paragrafi 3 i cili thotë se: "*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*", e që në rastin konkret faturat janë të nënshkruara dhe të pranuara nga debitori dhe se të njëjtat janë në origjinal. Andaj edhe kjo gjykatë e pranon përfundimin juridik të gjykatës se shkallës së parë ngase aktvendimi i ankimuar është i drejtë dhe i ligjshëm.

Në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.



2024:105701

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës ë Dytë për te vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë**

K.Dh.Sh II.nr. 626/24 me datë 20.06.2024

Gjyqtarja,

Franciska Zhitija Ymeri



2024:105701